



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. Prot.

Tiranë më / /2024

V E N D I M

Nr. 16, datë 28.02.2024

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Ersa Karaj	Kryesues
Klevis Dhigoi	Relator
Erjana Pjetri	Anëtar

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Lediana Azemaj, më datë 28.02.2024, ora 10:00, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë e dhënies së vendimit çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:

Z. Liman Imer Hoxha, me funksion Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore, në Gardën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AMP-së

Pasi dëgjoji gjetjet, bazuar në arsyetimin ligjor, si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes Klevis Dhigoi vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Liman Hoxha i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar,

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në vazhdim (AMP), është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Agjencisë Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi **z. Liman Imer Hoxha** është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023 si “Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e PLSH, Garda e Republikës së Shqipërisë”.

Subjekti i vlerësimit, **z. Liman Imer Hoxha**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin (nr.1, datë 18.04.2023) u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Klevis Dhigoi (Relator), znj. Erska Karaj (Kryesuese) dhe znj. Erjana Pjetri (Anëtare).

Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin (nr.1, datë 18.04.2023) vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **z. Liman Imer Hoxha**.

Relatori i çështjes, Z. Klevis Dhigoi nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë

e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 20.04.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, 42 dhe 46 të ligjit nr.12.2018, i ndryshuar relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit si më poshtë vijon:

- a. me shkresën nr.*** Prot, datë 19.04.2023 ka dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
- b. me shkresën nr.*** Prot, datë 19.04.2023 ka dërguar pranë Gardës së Republikës deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
- c. me shkresën nr.*** Prot, datë 19.04.2023 ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP-së deklaratën e kontrollit të figurës.

Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

- ✚ Vlerësimin e pasurisë;
- ✚ Kontrollin e figurës;
- ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.

Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar;
- b. Ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- c. Ligjin nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”;
- d. Ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;

- e. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
- f. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023. “Për hapat procedural të unifikuar”.

Gjithashtu, trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ✚ Deklaratën e Pasurisë;
- ✚ Deklaratën për Kontrollin e Figurës;
- ✚ Formulari i Vlerësimit Profesional;
- ✚ Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet;
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI;
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP;
- ✚ Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH;
- ✚ Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.

Trupa e vlerësimit ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

Trupa e vlerësimit, më datë 01.02.2024 pasi dëgjoi relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Liman Hoxha, me Vendimin Nr. 3 datë 01.02.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Liman Hoxha;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

- ✚ Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
- ✚ Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;

- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 13.02.2024, subjekti i vlerësimit Liman Imer Hoxha, kërkoi konfirmimin në detyrë dhe Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin në seancën e dhënies së vendimit në datë 28.02.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

❖ Subjekti i vlerësimi z. Liman Imer Hoxha ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar);

❖ Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave edhe dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatori, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatorit.

IV – A) VLERËSIMI I PASURISË

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. **Liman Imer Hoxha** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 08.03.2023, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka (nr.** , 2023).

Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- + deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- + raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- + provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- + dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

ILDKPKI, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetur, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit **z. Liman Imer Hoxha**, ku është konstatuar se:

A) I. DEKLARATA E PASURISË

Pasuria nr 1.

Llogari bankare në OTP Bank me IBAN *****, në emër të Liman Hoxha dhe bashkëshortes Majlinda Hoxha me gjendje 1.000.050 lekë .

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga ime si punonjës i Gardës së Republikës dhe puna e bashkëshortes. Vlera: 1.000.050 lekë.

Pjesa takuese: 50 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Konfirmim bankar nr. *** prot., datë 22.02.2023, lëshuar nga OTP Bank, ku vërtetohet se Liman Hoxha dhe Majlinda Hoxha disponojnë llogarinë bankare të hapur në datën 31.07.2019, me IBAN *****, me balancë 1.000.050 lekë.

Hetimi administrativ

OTP Bank me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon se në Alpha Bank (e cila është përthithur nga OTP Bank) Liman Hoxha dhe Majlinda Hoxha kanë llogarinë Alpha Start me balancë 1.000.900 lekë, në datën 08.03.2023. Referuar stamentit bankar, rezulton kreditimi i shumës 954.000 lekë në datën 31.07.2019, me përshkrimin “kalim mes dy llogarive”; kreditimi cash i shumës totale rreth 100.000 lekë për periudhën 19.09.2019 - 26.02.2020; debitimi cash i shumës 500.000 lekë në datën 02.04.2020; si dhe kreditimi cash i shumës totale rreth 452.500 lekë, për periudhën 05.02.2021 - 16.05.2022.

Gjithashtu, Majlinda Hoxha ka patur llogarinë Alpha Kursimesh, e hapur në datën 21.04.2015 dhe e mbyllur në datën 31.07.2019. Referuar stamentit bankar, rezulton kreditimi cash i shumës totale rreth 480.000 lekë, për periudhën 21.04.2015 - 07.12.2017; debitimi cash i shumës 30.000 lekë në datën 20.12.2017; kreditimi cash i shumës totale rreth 280.000 lekë, për periudhën 15.01.2018 - 25.06.2018; kreditimi cash i shumës totale rreth 220.000 lekë për periudhën 20.08.2018 - 03.07.2019; si dhe debitimi me transfertë mes dy llogarive, i shumës 954.000 lekë, në datën 31.07.2019.

Trupa e vlerësimit, kreu analizën financiare për periudhën 2015-2019 për subjektin e vlerësimit dhe personin e lidhur me të , mbi mundësinë për kursim për krijimin e kësaj pasurie, duke llogaritur për çdo vit të ardhurat nga paga dhe shpërblimet të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes së tij, duke zbritur shpenzimet jetike sipas INSTAT dhe shpenzime të tjera, nga ku në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Në lekë	2015-2017	2018	2019	TOTAL
Te ardhura nga punesimi L.H	3,044,073	1,253,006	1,429,564	5,726,643
Të ardhura nga biznesi M.H	817,327	346,301	320,300	1,483,928
Total te ardhura	3,861,400	1,599,307	1,749,864	7,210,571
Shpenzime qiraje	752,400	218,400	250,800	1,221,600
Shpenzime Kredi + interesa	105,990	0	206,000	311,990
Shpenzime INSTAT	2,077,824	772,620	759,312	3,609,756
Total Shpenzime	2,936,214	991,020	1,216,112	5,143,346
Hyrje ne llogari RFZ Bank	510,000	280,000	220,000	1,010,000
Mundesi per Kursim	415,186	743,473	1,057,225	1,057,225

❖ Konstatohet: Llogaria dyemërore në OTP Bank është krijuar gjatë eriu dhës 2015-2022.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e OTP Bank.**

DEKLARIMI TË ARDHURAVE

Subjekti ka deklaruar:

- Të ardhura nga paga për periudhën 17.03.1994 - 24.01.1999, sipas Vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare, marrë nga Reparti Usht. Nr. 6670, pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Shuma: 427.041 lekë.
- Të ardhura nga paga për periudhën 25.01.1999 - 31.12.2005, sipas Vërtetimit të Sektorit të Buxhet - Financës së Gardës së Republikës. Shuma: 4.279.132 lekë.
- Të ardhura nga paga për periudhën 01.01.2006 - Shkurt 2023, sipas Vërtetimit të Sektorit të Buxhet - Financës së Gardës së Republikës. Shuma: 14.852.598 lekë.
- Të ardhura nga motra ime, e cila jeton në Dibër, punojëse në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, në llogarinë time bankare në Raiffeisen Bank, më datë 08.05.2020. Shuma: 300.000 lekë.
- Më datë 01.06.2012 në llogarinë time, për kushuririn tim Q. H, është bërë një pagesë nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve për dëm të shkaktuar për kartonjeshil. Shuma: 90.600 lekë.
- Të ardhura nga shpërblimet dhe kompesimi i veshjes Civile në vlerë, për periudhën prill 2005 - Dhjetor 2021. Shuma: 523.277 lekë.

Subjekti i vlerësimit ka bashkëlidhur deklaratës:


Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare nr.*** prot., datë 01.03.2023, ku vërtetohet se, për periudhën 17.03.1994 - 24.01.1999, Liman Imer Hoxha ka realizuar të ardhura nga paga neto, me vlerë totale 427.041 lekë.

Vërtetim nga Garda e Republikës, datë 08.03.2023, ku vërtetohet se, për periudhën Janar 1999 - Dhjetor 2005, Liman Imer Hoxha ka përfituar të ardhura neto në shumën totale 4.279.132 lekë.

Vërtetim nga Garda e Republikës, datë 08.03.2023, ku vërtetohet se, për periudhën Janar 2006 -Shkurt 2023, Liman Imer Hoxha ka përfituar të ardhura neto në shumën totale 14.852.598 lekë.

Vërtetim nga Garda e Republikës, datë 08.03.2023, ku vërtetohet se, Liman Imer Hoxha: për periudhën Prill 2005 - Dhjetor 2021, ka përfituar të ardhura neto nga shpërblimet në shumën totale 362.977 lekë; si dhe për periudhën Janar 2007 - Dhjetor 2021, ka përfituar të ardhura neto për veshje Civile në shumën totale 160.300 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

- ** Raiffeisen Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se në emër të Liman Hoxha rezulton llogari page me balancë 6.784 lekë, në datën 08.03.2023.

Referuar statementit bankar, rezulton: kreditimi i të ardhurave nga paga, dietat, shpërblimet dhe kompesimi për veshje, për periudhën Maj 2005 - Mars 2023, në shumën totale rreth 17.052.686 lekë, nga të cilat shuma totale rreth 16.208.000 lekë për periudhën Janar 2006 - Mars 2023; kreditimi i shumës 90.600 lekë në datën 01.06.2012, me përshkrimin “..Byroja Shqiptare e Sigurimit tek Liman Hoxha për Q. H, Dëm Karton Jeshil, datë 31.05.2012..”; si dhe kreditimi i shumës 300.000 lekë në datën 08.05.2020, me përshkrimin “..B. K, derdhur në llogari..”.

✚ **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se për Liman Hoxha janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto dhe ka përfituar të ardhura nga paga neto, nga subjekti “Garda e Republikës”, për periudhën Janar 2012 - Mars 2023.

✚ **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.

✚ **ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. *** prot., datë 17.05.2023, sqaron se për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributive apo paga mbi të cilën janë siguruar, nqs. nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna. Bashkëlidhur: Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni me nr. *** prot., datë 15.05.2023, ku për saktësimin e verifikimit në arkivin e ISSH, për shtetasin Liman Hoxha, kërkohet librezë e punës, subjektet dhe rajoni ku ka punuar personi.

✚ **Nga kontrolli dhe verifikimet e kryera nga ILDKPKI dhe Trupa e vlerësimit, rezulton se subjekti nuk e ka deklaruar llogarinë bankare në Raiffeisen Bank me balancë 6.784 lekë në datë 08.03.2023, në rubrikën “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, sipas nenit 33, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.**

- Në proces-verbalin e datës 19.06.2023 (**ILDKPKI**), lidhur me llogarinë e pagës me balancë 6.784 lekë në datë 08.03.2023, subjekti ka sqaruar se për shkak të balancës relativisht minimale, duke patur parasysh deklarin e të ardhurave të kredituara në llogari, si dhe paraqitjen e statment bankar, është menduar i ezauruar detyrimi për deklarin.

- **Lidhur me shumën e kredituar në llogari të Raiffeisen Bank, më datë 08.05.2020, në shumën 300.000 lekë nga e motra e tij B. K,** subjekti sqaroi se është marrë përkohësisht sipas transaksionit bankar për nevoja familjare të momentit, është shpenzuar për restaurimin e banesës sipas deklarinimit dhe në vijim është kthyer cash brenda vitit kalendarik 2020 me burim financiar kursime nga të ardhurat familjare, duke

sqaruar se transaksioni është deklaruar në kushtet e transparencës, duke qenë marrëdhënie familjare e posaçme.

Lidhur me kreditimin e shumës 90.600 lekë, subjekti ka konfirmuar sipas deklaramit, duke sqaruar se ka qenë dëmshpërblim si rezultat i një aksidenti automobilistik, ku i dëmtuar ka qenë kushëriri i tij Q. H, duke saktësuar se për shkak të kohës së kaluar nuk disponon dokumentacion shtes, si dhe duke sqaruar se kreditimi është kryer në llogarinë e tij për shkak se në momentin e transaksionit, Q. H nuk është ndoshtur në republikën e shqipërisë, pasi jeton në Itali dhe se vlera i është dhënë cash nga ana e tij.

- Me inventar nr.extra prot., datë 19.06.2023, subjekti ka dorëzuar:
 - Vërtetim datë 12.06.2023, ku vërtetohet se B. K është punonjës pranë ISHSH Dibër, prej datës 12.03.2015 dhe në vazhdim, me pagë neto 68.708 lekë.
 - Vërtetim page datë 12.06.2023, ku vërtetohet se B. K është punonjëse pranë ISHSH Dibër dhe për muajin Prill 2023, është trajtuar me pagë neto 85.195 lekë.
- ✓ **Të ardhurat e subjektit nga paga, dieta dhe shpërblime, për periudhën 1994 - Mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 20.914.000.**

Subjekti ka deklaruar, ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me dy transaksionet e konfirmuara nga RFZ Bank, në vitin 2012 dhe vitin2020

DETYRIME FINANCIARE

- Kredi në vlerën 200.000 lekë, marrë në Raiffeisen Bank në datën 04.04.2006 dhe shlyer deri në datën 04.04.2008. Shuma e detyrimit financiar: 0 lekë.
- Kredi në vlerën 100.000 lekë, marrë në Raiffeisen Bank në datën 05.08.2008 dhe shlyer deri në datën 05.08.2010. Shuma e detyrimit financiar: 0 lekë.
- Kredi në vlerën 174.000 lekë, marrë në Raiffeisen Bank në datën 05.05.2010 dhe shlyer deri në datën 05.05.2014. Shuma e detyrimit financiar: 0 lekë.
- Kredi në vlerën 69.900 lekë, marrë në Raiffeisen Bank në datën 21.06.2012 dhe shlyer deri në datën 21.06.2013. Shuma e detyrimit financiar: 0 lekë.
- Kredi në vlerën 105.990 lekë, marrë në Raiffeisen Bank në datën 25.03.2016 dhe shlyer deri në datën 15.09.2016. Shuma e detyrimit financiar: 0 lekë.
- Kredi në vlerën 206.000 lekë, marrë në Raiffeisen Bank në datën 16.10.2019 dhe shlyer deri në datën 29.10.2020. Shuma e detyrimit financiar: 0 lekë.
- Kredi në vlerën 350.000, marrë në Raiffeisen Bank në datën 29.10.2020. Shuma e detyrimit financiar: 0 lekë.

Hetimi administrativ:

Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon;

- llogarinë në emër të Liman Hoxha, ku është disbursuar kredia në shumën 200.000 lekë në datën 04.04.2006, e shlyer deri në datën 04.04.2008.
- llogarinë në emër të Liman Hoxha, ku është disbursuar kredia në shumën 100.000 lekë në datën 05.08.2008, e shlyer deri në datën 05.05.2010.
- llogarinë në emër të Liman Hoxha, ku është disbursuar kredia në shumën 174.160 lekë në datën 05.05.2010, e shlyer deri në datën 05.05.2014.
- llogarinë në emër të Liman Hoxha, ku është disbursuar kredia për blerje në QTU, në shumën 69.900 lekë, në datën 21.06.2012, e shlyer deri në datën 03.06.2013.
- llogarinë në emër të Liman Hoxha, ku është disbursuar kredia në shumën 105.990 lekë në datën 25.03.2016, e shlyer deri në datën 15.09.2016.
- llogarinë në emër të Liman Hoxha, ku është disbursuar kredia në shumën 206.000 lekë në datën 16.10.2019, e shlyer deri në datën 29.10.2020.
- llogarinë në emër të Liman Hoxha, ku është disbursuar kredia në shumën 350.000 lekë në datën 29.10.2020, e shlyer deri në datën 20.12.2021.

Në proces-verbalin e datës 19.06.2023, subjekti sqaroi se kreditë janë disbursuar dhe shpenzuar për qëllime konsumi duke saktësuar se nuk disponon dokumentacion shtesë.

- Konstatohet: Kreditë konsumatore janë marrë dhe shlyer gjatë periudhës 2006 - 2021.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

SHPENZIME TË DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese. ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur, Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Gjatë periudhës Shkurt 2022 - Shkurt 2023; pagesë për ujë, sipas kontratës me nr. ****, në emër të Liman Hoxha. Shuma: 20.400 lekë.
- Gjatë periudhës Janar 2022 - Dhjetor 2022; pagesë për energji elektrike, sipas kontratës me nr. 52655, në emër të Liman Hoxha. Shuma: 56.789 lekë.
- Pagesë për numër telefoni dhe internet. Shuma: 29.800 lekë.

Hetimi administrativ:

FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 19.05.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Liman Hoxha identifikohen 17 abonentë me kontratë furnizimi për energji elektrike.

FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Majlinda Hoxha identifikohen 12 abonentë me kontratë furnizimi për energji elektrike.

Shoqëria Raionale Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë sh.a me shkresën nr. *** prot., datë 16.06.2023, konfirmon se rezultton:

- Kontrata nr. ****, për objekt me adresë: Rr. “Niko Avrami”, me status “aktive” në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të palikuiduara me vlerë 380.230 lekë deri në datën 18.05.2023, në emër të Majlinda Hoxha; ku citohet se nuk disponohet asnjë dokumentacion i arkivuar dhe nuk është e sigurtë nëse është i njëjti person me shtetasen Majlinda Sulejman Hoxha, për të cilën është kërkuar informacion, B/lidhur: Praktika.
- Kontrata nr. ****, për objekt me adresë: Rr. “Qemal Stafa”, me status “aktive” në kategorinë e konsumatorëve privat, me detyrime të likuiduara deri në Mars 2023, në emër të Majlinda Hoxha; ku citohet se nuk disponohet asnjë dokumentacion i arkivuar dhe nuk është e sigurtë nëse është i njëjti person me shtetasen Majlinda Sulejman Hoxha, për të cilën është kërkuar informacion.

Shoqëria Raionale Ujësjellës - Kanalizime Durrës sh.a. me shkresën nr. *** prot., datë 29.05.2023, konfirmon:

- Kontratë nr. ****, me adresë: Xhafzotaj, Shijak, në emër të Liman Hoxha;
- Kontratë nr. ****, me adresë: Lagjia nr. **, Rruga 'Cerlonjve ', Durrës, në emër të Majlinda Hoxha;
- Kontratë nr. ****, me adresë: Lagjia nr. **, Plazh, Durrës, në emër të Majlinda Hoxha;

ku citohet se kontratat nuk disponohen dhe nuk është e sigurtë nëse janë të njëjtët persona me shtetasit Liman Imer Hoxha dhe Majlinda Sulejman Hoxha, për të cilët është kërkuar informacion.

Shoqëria Raionale Ujësjellës - Kanalizime Elbasan sh.a. me shkresën nr. *** prot., datë 24.05.2023, konfirmon:

- Kontratë nr. *** në emër të Majlinda Hoxha, pa atësi, me vend ndodhje në lagjen “Sule Papri”. Bashkëlidhur: Kontrata nr. ***, datë 01.04.2009, me konsumator Majlinda Hoxha, për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujrave të zeza. Referuar tabelës bashkëlidhur, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, për kontratën nr. ***, është faturuar dhe likuiduar vlera totale rreth 9.774,36 lekë.
- Kontratë nr. *** në emër të Majlinda Hoxha, pa atësi, me vend ndodhje në lagjen “Aqif Pasha” Referuar tabelës bashkëlidhur, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, për kontratën nr. ***, është faturuar dhe likuiduar vlera totale rreth 17.353,31 lekë; ku citohet se nuk është e sigurtë nëse është i njëjti person me shtetasen Majlinda Sulejman Hoxha për të cilën është kërkuar informacion.

12 Shoqëri Raionale të Ujësjellës - Kanalizime, me shkresat nr. ***- *** prot., nr. ***-*** prot. dhe nr.***-*** prot., datë 05.05.2023 deri në 17.07.2023 nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Vodafone Albania sh.a. me shkresën nr. *** prot., datë 08.06.2023, konfirmon se: në emër të Liman Hoxha rezultojnë dy numra telefonik, për të cilët janë paguar detyrimet

me vlerë totale rreth 32.600 lekë, për vitin 2022; si dhe në emër të Majlinda Hoxha rezulton një numër telefonik aktiv, për periudhën 21.06.2018 - 02.12.2020.

- ✚ **One Albania sh.a**, me shkresën nr. *** prot., datë 21.07.2023, konfirmon se në emër të Majlinda Hoxha rezulton një numer telefonik, per të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 11.650 lekë, për vitin 2022.
- ✚ **Albania Satellite Communications shpk**, me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Abissnet sh.a**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.
- ✚ **Digicom sh.a**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

Në proces-verbalin e datës 19.06.2023 (ILDKPKI), subjekti sqaroi se vlerat e shpenzimeve për ujë dhe energji elektrike janë llogaritur nga ana e tij për periudhën Janar - Dhjetor 2022, duke u deklaruar me përafërsi. Lidhur me shpenzimet telefonike, subjekti ka konfirmuar se vlera e deklaruar është llogaritur nga ana e tij me përafërsi për periudhën Shkurt 2022 - Shkurt 2023, duke paraqitur dokumentacion vërtetues lidhur me shpenzimet telefonike të kryera për periudhën Janar - Dhjetor 2022.

Për shpenzimet e bashkëshortes si person i lidhur, subjekti ka konfirmuar shpenzimet e përbashkëta për furnizimin me ujë dhe energji elektrike si dhe ka sqaruar se për shpenzimet telefonike bashkëshortja nuk ka disponuar kontratë me pagesë të rregullt por ka kryer ofertat mujore pranë kompanisë celulare Eagle Mobile (aktualisht ONE) me shpenzime përafërsisht 1.100 lekë në muaj.

Lidhur me konfirmimet e FSHU dhe Ujësjiellës Kanalizime sh.a, evidentuar si më sipër, subjekti ka konfirmuar se sipas korrespondencës me FSHU për “..Klientin nr. *****, Instanca: Tirana ***, adresa: “A Pas N Sh Rak...” kjo kontratë i përket apartamentit të deklaruar nga bashkëshortja, ndërsa lidhur me kontratat e tjera, ka sqaruar se nuk disponohet asnjë prej tyre dhe nuk ka asnjë informacion lidhur me përkatësinë.

❖ **Me inventarin nr.extra prot., datë 19.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:**

- Kopje e librezës së OSHEE, për kontratën nr. ***, në emër të Liman Hoxha, ku rezulton shlyerja e detyrimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën totale rreth 56.500 lekë.
- Kopje e librezës së UKT, për kontratën nr. ***, në emër të Liman Hoxha, ku rezulton shlyerja e detyrimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2022, në shumën totale rreth 20.500 lekë.

- Tabelë përmbledhëse nga Vodafone Albania, ku rezulton se: për periudhën Janar 2022 - Dhjetor 2022, Liman Hoxha ka paguar detyrimet për pagesën e faturave si abonent, me vlerë totale rreth 32.600 lekë.

❖ **Me inventarin nr.extra prot., datë 22.06.2023, subjekti ka dorëzuar:**

- Kthim përgjigje nga One Albania sh.a, ku vërtetohet se abonenti Majlinda Hoxha ka shpenzuar për numrin celular, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, shumën totale rreth 11.650 lekë.

Në përfundim të hetimit mbi shpenzimet e deklaruar të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur, periudha 01.01.2022 - 31.12.2022), trupa e vlerësimit konkludoi se:

- ✓ **Shpenzimet e subjektit dhe të bashkëshortes për ujë, drita, telefon dhe internet, gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, rezultojnë ne total rreth 121.000 leke.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e Vodafone Albania sh.a dhe ONE Albania sh.a.**
- ✓ **Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues për shpenzimet e deklaruar për ujë dhe energji elektrike, si dhe ka dhënë shpjegime për kontratat e konfirmuara nea FSHU dhe UK, që nuk i përkasin atij dhe bashkëshortes.**

Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 — 31.12.2022.

❖ **Udhëtime në Vitin 2020:**

- Nga data 04.01.2020 deri në datë 09.01.2020, kam udhëtuar me autobus nga PKK Kakavijë për në drejtim të Egio, Greqi, për të vizituar familjen e motrës time. Gjithsej 6 ditë. Shuma e shpenzuar: 300 euro.

❖ **Shpenzime për udhëtime për Vitin 2021:**

- Në datat 04.06.2021, 05.06.2021, 11.06.2021 dhe 07.07.2021, kam udhëtuar me mjet privat nga PKK Qafë Thanë, për në Maqedoninë e Veriut (Ohër), për arsye të vizitës në Spitalin Ortopedik të Ohrit, duke qenë se vëllai im ka kryer një ndërhyrje ortopedike. Më datë 11.16.2021, kam dalë nga Pika e Kalimit Kufitar Bllatë, së bashku me bashkëshorten. Shuma e shpenzuar: rreth 300 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me nr. *** prot., datë 28.02.2023, ku vërtetohet se sipas sistemit TIMS, shtetasi Liman Hoxha: ka dalë me autobus nga PK Kakavijë në datën 04.01.2020 dhe ka hyrë me autobus nga PK Kakavijë në datën 09.01.2020.
- Kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me nr. *** prot., datë 28.02.2023, ku vërtetohet se sipas sistemit TIMS shtetasi Liman Hoxha: ka dalë me autoveturë nga PK Qafë Thanë në datën 04.06.2021 dhe ka hyrë me autoveturën me targë IYE ****, nga PK Qafë Thanë në datën 04.06.2021; ka dalë me autoveturën me targë IYE ****, nga PK Qafë Thanë në datën 5.6.2021 dhe ka hyrë me autoveturën me targë IYE ****, nga PK Qafë Thanë në datën 05.06.2021; ka dalë me autoveturën me targë AA *** BV, nga PK Qafë Thanë në datën 11.06.2021 dhe ka hyrë me autoveturën me targë AA *** BE nga PK Bllatë në datën 11.06.2021; ka dalë me autoveturën me targë TR **** S, nga PK Qafë Thanë në datën 07.07.2021 dhe ka hyrë me autoveturën me targë TR **** S, nga PK Qafë Thanë në datën 07.07.2021.
- Kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me nr. *** prot., datë 28.02.2023, ku vërtetohet se sipas sistemit TIMS shtetasja M. H: ka dalë me autoveturën me targë AA *** BE nga pika kufitare Qafë Thanë, në datën 11.06.2021 dhe ka hyrë me autoveturën me targë AA *** BK nga pika kufitare, Bllatë në datën 11.06.2021.
- **Në proces-verbalin e datës 19.06.2023**, subjekti ka konfirmuar vlerat e llogaritura me përafërsi nga ana e tij, duke sqaruar se nuk disponon dokumentacion vërtetues. Lidhur me automjetet me të cilat ka udhëtuar, sqaroi se janë përdorur nga shtetasi Th. G, mik i tij, me të cilin ka udhëtuar në të gjitha rastet e evidentuara si më sipër. Lidhur me pronësinë e automjeteve, saktësoi se mjete me targë AB ** BV është në pronësi të S. Sh, bashkëshortes së shtetasit Th. G, mjete me targë IYE **** është me dokumentacion Grek dhe nuk ka njohuri lidhur me pronësinë duke konfirmuar se automjeti ka qenë në përdorim të mikut të tij Th. G, mjete me targë TR **** S është në pronësi të shtetasit P. L, me të cilin nuk ka njohje por konfirmon se automjeti ka qenë në përdorim të mikut të tij Th. G.

Me inventarin nr.extra prot.. datë 19.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Leje Qarkullimi të automjetit me targë AB *** BV i regjistruar në pronësi të shtetasës S. Sh.
- Dokumentacion në gjuhën Greke, për automjetin me targë IYE ****.
- Leje Qarkullimi të automjetit me targë TR **** S, i regjistruar në pronësi të shtetasit P. L.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e dhëna dhe dokunaentacionin e dorëzuar, sa i përket hyrje-daljeve nga R.SH, të subjektit dhe bashkëshortes, gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022.**

- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për udhëtime private, të subjektit dhe bashkëshortes së tii, gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022. rezultojnë në total rreth 600 euro, e konvertuar rreth 70.000 lekë.**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - MAJLINDA HOXHA

DEKLARIMI I PASURIVE

Pasuria nr. 1.

Pasuria nr. ***, ZK nr. ****, lloji i pasurisë: Godinë me sipërfaqe totale 81.88 m2, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, në emër të **Majlinda Sulejman Hoxha, me nr. 203****, nga ZVRPP Dr. Tirana Veri.**

Burimi i krijimit: Më datë 13.6.1997 kemi marrë nga Ministria e Mbrojtjes autorizim në emër të bashkëshortit tim Liman Hoxha, këtë objekt për ta përshtatur për banesë. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 2013, ky objekt i ka kaluar për privatizim Entit Kombëtar të Banesave. Bashkëshorti im, këtë objekt e ka kaluar në emrin tim me prokurë nr. *** rep., nr. *** kol., dhe unë kam vijuar procedurën për privatizimin e këtij objekti. Disponoj të gjithë dokumentacionin e duhur. Shpenzimet janë bërë nga paga e bashkëshortit si punonjës i Gardës së Republikës dhe nga paga ime gjatë kohës së punësimit. Vlera: Rreth 3.500.000 lekë, për ta përshtatur për banim ndër vite.

Vlera: Gjatë procesit të privatizimit është paguar nëpërmjet Credins Bank, shuma 383.974 lekë, sipas detyrimeve të Entit të Banesave.

Pjesa takuese: 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, nga zyra e regjistrimit ZVRPP Dr. Tirana Veri, për pasurinë nr. ***, vol. **, faqe **, zk ****, e llojit Godinë me sipërfaqe totale 81.88 m2, regjistruar në pronësi të Majlinda Sulejman Hoxha.
- Kartela e pasurisë nr. ***, vol. **, faqe **, zk ****, e llojit Godinë me sipërfaqe totale 81.88 m2, regjistruar në pronësi të Majlinda Sulejman Hoxha në datën 11.05.2020, në shumën e paguar 384.434 lekë, referuar shënimeve “K. Sh. ****, datë 14.04.2020”. Bashkëlidhur: Harta Treguese e Regjistrimit.
- Kontratë shitje përfundimtare nr. *** rep. , nr. *** kol., datë 14.4.2020, me blerës Majlinda Sulejman Hoxha dhe shitës Enti Kombëtar i Banesave, për ambient banimi në bashkëpronësi të pandarë me sipërfaqe totale 81.88 m2. Hera e plotë e detyrimit financiar 384.434 lekë, likuiduar sipas mandat arkëtimit datë 30.3.2020 në Credins Bank.

Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kërkuar të dhëna nga institucione publike

dhe private të cilat në bazë të ligjit janë të detyruara të japin të dhëna. ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u është drejtuar institucioneve të mëposhtme:

- Agjensia Shtetërore e Kadastrës
- Drejtoritë Vendore në rreth dhe Zyrat Vendore të ASHK
- ISSH
- FSHU
- 15 Shoqëri Rajonale Ujësjellës – Kanalizime.
- Regjistri Noterial Shqiptar
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- QKB.

Informacioni i dërguar nga këto institucione që japin të dhëna në interes të asetit të deklaruar janë si më poshtë:

- ✚ **ASHK (online)**, konfirmon pasurinë nr. ***, vol. **, faqe **, zk ****, të ndodhur në Tiranë, në pronësi të Majlinda Sulejman Hoxha, me status “aktive”.
- ✚ **ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri**, me shkresën nr. *** prot., datë 03.07.2023, konfirmon pasurinë nr. ***, vol. **, faqe **, zk ****, në pronësi të Majlinda Sulejman Hoxha. Bashkëlidhur: Kartela e Pasurisë, ku rezulton regjistrimi i pasurisë së llojit godinë me sipërfaqe 81.88 m², në datën 11.05.2020, në shumën e paguar 384.434 lekë, me shënimin “..K. Sh. Nr. 278/158, at. 14.4.2020..”.

Në proces-verbalin e datës 19.06.2023, subjekti ka sqaruar se shpenzimet e deklaruara për investim në banesë janë llogaritur nga ana e tij me përafërsi, duke qenë shpenzime të kryera për periudhën 1999 - 2023 dhe për të cilat, për shkak të periudhës së gjatë nuk disponon dokumentacion vërtetues, si dhe në pamundësi të disponimit të dokumentacionit të saktë, sqaroi se paraqet disa preventive për punime si dokumentacion lidhur me investime hipotetike të ngjashme me investimet e kryera në banesën e tij dhe oferta të ndryshme lidhur me çmimin për mobilim, të ngjashëm me mobilimin e banesës së tij. Lidhur me procedurën e privatizimit subjekti ka sqaruar se fillimisht banesa është marrë për strehim në vitin 1997 dhe në vijim janë ndjekur të gjitha procedurat, si dhe sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 23.12.2019, ka hequr dorë nga privatizimi në favor të bashkëshortes Majlinda Hoxha dhe në vijim është lidhur kontrata përfundimtare datë 14.04.2020, duke u likuiduar shuma, sipas mandatit në Credins Bank.

Me inventarin nr. extra prot.. datë 19.06.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Autorizim nr. *** regj., datë 13.06.1997, për strehimin e Liman Hoxha në objektin e ndodhur në Rr. “Durrësit”, Tiranë.
- Vendim nr. ***, datë 13.06.2013, për kthimin në fond banesash të ish-objekteve ushtarake në ish-komandën e Forcave Detare, në Laprakë, Tiranë.
Bashkëlidhur: Lista e kryefamiljarëve që janë trajtuar me banesë dhe që nuk i kanë privatizuar akoma, ku rezulton i listuar subjekti Liman Hoxha.

Njoftim nga Enti Kombëtar i Banesave, datë 20.09.2017, drejtuar subjektit Liman Hoxha, për plotësim dokumentacioni. Bashkëlidhur: Praktika.

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2019, ku citohet se Liman Hoxha heq dorë nga procesi për të qenë pjesë dhe përfitues në privatizimin e banesës me adrese: Rr. Durrësit, me nr. Pasurie ***, zk ****, vol. **, faqe **, Tiranë, të cilin e posedon së bashku me bashkëshorten, duke qenë dakord që privatizimi i kësaj banese te vazhdojë në emër të bashkëshortes Majlinda Hoxha, e cila deklaroi se është dakord me sa më sipër cituar.
- Mandat nga Credins Bank, datë 14.04.2020, ku rezultoi depozitimi i shumës 383.974 lekë, nga Majlinda Hoxha në favor të Entit Kombëtar të Banesave, me përshkrimin “..për privatizim..” Bashkëlidhur: Praktika.
- Ofertë për punime dhe mobilim banese, nga Erald shpk, datë 20.03.2001, me vlerë totale rreth 233.800 lekë.
- Preventiv për rikonstruksion objekti banimi apartament 2+1, datë 20.09.2001, me vlerë totale rreth 817.425 lekë. Bashkëlidhur praktika.
- Preventiv për lyerje dhe patinim banese, nga OAS, datë 05.03.2010, me vlerë totale rreth 100.500 lekë.
- Preventiv për lyerje dhe patinim banese, nga OAS, datë 21.07.2015, me vlerë totale rreth 189.000 lekë.
- Ofertë për punime dhe mobilim banese nga Bolt shpk, datë 04.05.2020, me vlerë totale rreth 436.000 lekë.
- Ofertë për punime ndërtimore, elektrike dhe mekanike, nga G. K , datë 13.06.2020, me vlerë totale rreth 1.501.190 lekë.
- Preventiv për blerje paisjesh elektroshtëpiake, datë 07.07.2020, me vlerë totale rreth 229.600 lekë.

Bazuar në deklarinë e subjektit dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

Godina me sipërfaqe 81.88 m², e ndodhur në Rr. “Durrësit”, Laprakë, Tiranë, në pronësi 100% të bashkëshortes është përfituar fillimisht për strehim nga subjekti, në vitin 1997 dhe në vijim janë ndjekur procedurat e privatizimit nga bashkëshortja e tij deri në blerjen përfundimtare nga E.K.B. në vitin 2020, duke kryer investime periodike për përshtatjen për banim dhe për mobilim me burim financiar kursime nga të ardhurat familjare. Prej vitit 1999 dhe në vijim, referuar deklarinëve të subjektit, janë shpenzuar për investime periodike për përshtatjen për banim dhe për mobilimin e godinës, shuma totale rreth 3.500.000 lekë. Për blerjen përfundimtare të godinës në datën 14.04.2020, është likuiduar shuma 383.974 lekë, në datën 30.03.2020, në favor të Entit Kombëtar të Banesave.

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe trupa e vlerësimit pranë AMP-së, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**
- ✓ **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.**

Pasuria nr. 2.

Llogari bankare në OTP Bank, me IBAN *****, në emër të Liman Hoxha dhe bashkëshortes Majlinda Hoxha. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si punonjës i Gardës. Vlera: 1.000.050 lekë. Zotëron 50%.

- ✓ **Traituar më sipër.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

*Të ardhura nga data 04.09.2015 deri në Dhjetor 2019, nga ushtrimi i profesionit si parukiere me NIPT *****, në një ambient privat rreth 35 m2, i marrë me qira, në pronësi të B. Ll, së bashku me pajisjet e parukerisë. Aktivitet i çregjistruar në datën 25.02.2020. Shuma: rreth 1.492.261 lekë.*

❖ Bashkëlidhur deklaratës:

- *Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën tatimore ***, ku vërtetohet se Majlinda Hoxha, si Person Fizik me NIPT *****, ka realizuar të ardhura në vlerën totale 143.600 lekë, nga e cila fitimi 143.600 lekë.*
- *Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, përperiudhën tatimore ***, ku vërtetohet se Majlinda Hoxha, si Person Fizik me NIPT *****, ka realizuar të ardhura në vlerën totale 406.300 lekë, nga e cila fitimi 406.300 lekë.*
- *Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbifitimin, përperiudhën tatimore ***, ku vërtetohet se Majlinda Hoxha, si Person Fizik me NIPT *****, ka realizuar të ardhura në vlerën totale 575.200 lekë, nga e cila shpenzimet me vlerë 299.440 lekë dhe fitimi 275.760 lekë.*
- *Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën tatimore ***, ku vërtetohet se Majlinda Hoxha, si Person Fizik me NIPT *****, ka realizuar të ardhura në vlerën totale 648.101 lekë, nga e cila shpenzimet me vlerë 301.800 lekë dhe fitimi 346.301 lekë*
- *Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën tatimore ***, ku vërtetohet se Majlinda Hoxha, si Person Fizik me NIPT*****, ka realizuar të ardhura në vlerën totale 622.800 lekë, nga e cila shpenzimet me vlerë 302.500 lekë dhe fitimi 320.300 lekë.*

- ✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, konfirmon se Majlinda Sulejman Hoxha, figuron si Person Fizik me NUIS (NIPT) *****, e regjistruar në datën 02.09.2015, me fushë veprimtarie “Parukeri”, vend ushtrimi te aktivitetit “Tiranë”, me status “çregjistruar” prej datës 24.02.2020.

- ✚ **DPT** me shkresën nr. ***prot, datë 11.05.2023, konfirmon se Majlinda Hoxha figuron si Person Fizik me NIPT *****, e regjistruar pranë D.R.T. Tiranë, në datën 02.09.2015.
- ✚ **D.R.T Tiranë** me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Majlinda Sulejman Hoxha figuron si Person Fizik me NIPT *****, e regjistruar në datën 02.09.2015. Referuar sistemit tatimor C@ts, subjekti tregtar ka deklaruar: qarkullim në shumën totale rreth 1.635.829 lekë, nga e cila fitimi pas tatimit në shumën totale rreth l. 348.661 lekë, për periudhën 2016-2019, dhe përkatësisht fitim për vitin 2016 në shumë 406.300 lekë; fitim për vitin 2017 në shumën 275.760 lekë; fitim për vitin 2018 në shumën 346.301 lekë; si dhe fitim për vitin 2019 në shumën 320.300 lekë.
- ✚ **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, konfirmon se për Majlinda Hoxha janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto, si e vetëpunësuar, për periudhën Shtator 2015 - Dhjetor 2019.
- ✚ **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023 i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.
- ✚ **ISSH. Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. *** prot., datë 17.05.2023, sqaron se për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha e kontributive apo paga mbi të cilën janë siguruar, nëqoftëse nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna. Bashkëlidhur: Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni me nr. *** prot., datë 15.05.2023, ku për saktësimin e verifikimit në arkivin e ISSH, për shtetasen Majlinda Hoxha, kërkohet librezë e punës, subjektet dhe rajoni ku ka punuar personi.

Në proces-verbalin e datës 19.06.2023, subjekti ka konfirmuar marrjen me qira të ambientit me sipërfaqe 35 m2, me kontratën e datës 12.08.2016, me afat 01.09.2016 - 31.08.2018. Ka sqaruar se nuk disponon kontratat për periudhat e tjera, duke konfirmuar se janë shlyer detyrimet tatimore për tatimin në burim, deri në datën 07.01.2020, sipas dokumentacionit të disponuar dhe të paraqitur në vijim. Subjekti ka konfirmuar se bashkëshortja ka ushtruar aktivitetin privat me NIPT *****, dhe ka përfutuar të ardhura sipas deklaramentit, duke konfirmuar se shpenzimet pas martesore për konsum, kanë si burim financiar të ardhurat familjare ndër vite.

Me inventarin nr. extra prot., datë 19.06.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.08.2016, me qiramarrës Majlinda Hoxha, qiradhënëse V. Ll dhe B. Ll, për marrjen me qira të ambientit me sipërfaqe 35 m2, të ndodhur në Rr. e Durrësit, Tiranë, për tu përdorur si parukeri për periudhën 01.09.2016 - 31.08.2018, me qira mujore 18.200 lekë.
- Mandat pagesa të tatimit në burim me vlerë 2.700 lekë në muaj dhe pagesave të detyrimeve të tjera, nga Majlinda Hoxha PF me NIPT *****, për periudhën Shtator 2015 -Dhjetor 2016 dhe për periudhën Janar 2018 - Dhjetor 2019.

- Vërtetim me vulë elektronike, datë 12.06.2023, ku vërtetohet se Majlinda Hoxha nuk është regjistruar në DRT Tiranë, sipas sistemit informatik.

Me inventarin nr.extra prot., datë 22.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Certifikatë martese datë 21.06.2023, me bashkëshort Liman Hoxha dhe bashkëshorte Majlinda Hoxha, me datë lidhje të martesës 16.09.1996. Bashkëlidhur: Praktika.
- ✓ **Të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat si Person Fizik. për periudhën 02.09.2015 - 24.02.2020, konfirmohen në vlerën totale rreth 1.492.000 lekë.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE KONFIDENCIALE

- Certifikatë vërtetim pronësie Nr. 203***, në emër të Majlinda Sulejman Hoxha, nga ZVRPP Dr. Tirana Veri, zona kadastrale nr. *****, nr. pasurie ***, volumi **, faqe **, lloji i pasurisë: Godinë me sipërfaqe totale 81.88 m2. Kontratë shitje nga Enti Kombëtar i Banesave nr. *** rep., nr. *** kol.
- ✓ **Trajtuar më sipër.**

Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Liman Hoxha ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile: Njësia Administrative nr. **, Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa nr. **: Hyrja nr. *, Bashkia Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë personale datë 27.02.2023, për Liman Imer Hoxha, i datëlindjes 03.03.1970, me vendbanim “Dritan Hoxha”, Nd. **, H **, Njësia Administrative nr. *, **** Tiranë.
- Certifikatë personale datë 27.2.2023, për Majlinda Sulejman Hoxha, e datëlindja 26.04.1972, me vendbanim “Dritan Hoxha”, Nd. **, H. **, Nj. Administrative nr. *, ****, Tiranë'.

Në proces-verbalin e datës 19.06.2023. subjekti ka konfirmuar se adresa është deklaruar sipas adresarit të kryer nga Bashkia Tiranë, duke sqaruar se i përket apartamentit të deklaruar nga bashkëshortja, me sip. 81.88 m2.

- ✓ Adresa e regjistrimit në gjendjen civile i përket pasurisë së llojit godinë me sipërfaqe 81.88 m². të trajtuar më sipër.

Banka e Shqipërisë, BKT, Intesa Sanpaolo Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Amerikane e Investimeve, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar Tiranë, AKinvest, EasyPay shpk, Fondi Besa, NOA, IUTECREDIT

Albania, Kredo Financë shpk, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarinimin

✚ **ASHK, Zyrat/Drejtoritë Vendore – Librazhd, Mallakastër, Devoll, Korçë, Fier, Berat, Lezhë, Lushnjë, Krujë, Kuçovë, Gjirokastrë, Tirana Jug, Malësi e Madhe Kukës, Kavajë, Bulqizë, Skrapar, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mirditë, Sarandë, Dibër, Pogradec, Vlorë, Dibër, Shkordër, Kurbin**, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se referuar statementit bankar, në emër të Majlinda Hoxha ka rezultuar llogaria në euro, e hapur në datën 13.01.2015 dhe e mbyllur në datën 16.01.2017.

✓ **Llogaria rezulton me status “mbyllur”. Ka patur transaksione me vlera të justifikueshme.**

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se në emër të Majlinda Sulejman Hoxha ka rezultuar llogaria me nr. 130***, pa transaksione të kryera.

✓ **Llogaria rezulton pa veprim.**

✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se në emër të Liman Ymer Hoxha, rezultojnë llogari në monedhën lekë dhe në monedhën usd, aktive për periudhën 2002 - 2005.

✓ **Gieneralitetet e konfirmuara nga Tirana Bank për mbajtësin e llogarisë me status “mbyllur” nuk përputhen me gjeneralitetet e subjektit Liman Imer Hoxha. për të cilin është kërkuar informacion.**

✚ **OTP Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon se në Alpha Bank (e cila është përthithur nga OTP Bank) Majlinda Hoxha ka patur llogari në Alpha Kursimesh në Euro, e hapur në datën 15.09.2014 dhe e mbyllur në datën 27.07.2018.

✓ **Llogaria rezulton me status “mbyllur”.**

✚ **Raiffeisen Invest**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Liman Imer Hoxha ka një marrëdhënie juridike duke investuar në Fondin Prestigj, duke filluar nga data 10.02.2021 dhe duke disponuar 0,6332 kuota me vlerë 995 lekë, në datën 08.03.2023. Referuar pasqyrave të llogarisë rezulton: blerja e 7,6838 kuotave për shumën 12.000 lekë, për periudhën 10.02.2021 - 10.01.2022; shitja e 7,6838 kuotave me vlerë 12.121 lekë, në datën 24.01.2022 (nga të cilat tatimi me vlerë 18,18 lekë); si dhe blerja e 0,6332 kuotave me vlerë 1.000 lekë, në datën 10.02.2022.

- **Në proces-verbalin e datës 19.06.2023**, subjekti ka konfirmuar investimin e kryer duke sqaruar se për shkak të balancës minimale nuk është evidentuar në formular.
- ✓ **Llogaria rezulton me balancë minimale.**
- ✚ **Unioni Financiar Tiranë**, me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, konfirmon se nëpërmjet Ëestern Union, për periudhën 27.04.2018 - 08.03.2023: Liman Hoxha ka kryer një transaksion në hyrje, në shumën e tërhequr 54.664 lekë; si dhe Majlinda Hoxha ka kryer tre transaksione në hyrje, në shumën totale të tërhequr 700 euro.
- **Në proces-verbalin e datës 19.06.2023**, subjekti ka sqaruar se shuma e tërhequr nga ana e tij prej 54.664 lekë është dërguar nga shtetasi A. P nga SHBA me destinacion familjen e të ndjerit B. S, shumë e cila i është dhënë familjes cash nga ana e tij.
- Lidhur me transaksionet e kryera nga bashkëshortja e tij, subjekti ka sqaruar se janë dy dërgesa në formë dhurimi, me vlerë totale 500 euro, nga motra e saj A. H nga Italia dhe dërgesa me vlerë 200 euro në formë dhurimi, nga mbesa e bashkëshortes L. M nga Gjermania, për të cilat nuk disponon dokumentacion shtesë.
- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me transaksionet e kryera.**
- ✚ **AK Invest**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon se shtetasja me gjeneralitetet Majlinda Hoxha (jo-klient) ka kryer dërgesa jashtë territorit të Shqipërisë, për të cilat pritet informacion lidhur me gjeneralitetet nga MoneyGram International.
- **AK Invest**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se sipas përgjigjes së MoneyGram International (bashkëlidhur) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë kryer transaksione për transfertat monetare.
- ✚ **ASHK**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.06.2023, konfirmon se nga verifikimi digjital të vendimeve të legalizimit, rezulton se Majlinda Sulejman Ceni (Hoxha) është pajisur me vendim legalizimi nr. 127***, datë 27.11.2020, për apartamentin nr. 8 (universal shpk) Njësia Administrative nr. 5, Tiranë.
- **Në proces-verbalin e datës 19.06.2023**, lidhur me përgjigjen e ASHK nr. *** prot., datë 12.06.2023, subjekti sqaroi se mbiemri i vajzërisë së bashkëshortes ka qenë Karasani.
- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me sa më sipër.**
- ✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, nuk konfirmon mjete të regjistruara në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur.
- ✚ **DPT**, me shkresën nr.*** prot, datë 11.02.2023, konfirmon se Liman Hoxha figuron si Person Fizik me NIPT *****, i regjistruar pranë D.R.T. Tiranë, në datën 20.04.2006.
- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.06.2023, konfirmon se Liman Hoxha (nuk disponohet datëlindja) figuron si Person Fizik me NIPT K61703****, i regjistruar

në datën 20.04.2006, me aktivitet “shërbime personale” dhe i çregjistruar në datën 09.01.2008.

- Në proces-verbalin e datës 19.06.2023, lidhur me përgjigjet e DPT dhe DRT Tiranë, subjekti ka sqaruar se ai nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitet privat.
- Me inventarin nr.extra prot., datë 19.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:
- *Vërtetim me vulë elektronike, datë 13.06.2023, ku vërtetohet se Liman Hoxha nuk është regjistruar në DRT Tiranë, sipas sistemit informatik.*

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me sa më sipër.**

✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.05.2023, konfirmon se, Majlinda Hoxha: figuron si person fizik me NIPT K32509****, regjistruar pranë D.R.T. Berat, në datën 14.11.1992; dhe figuron si administrator në subjektin “Qendra Agritra-Vizion” me NIPT K36315****, regjistruar pranë D.R.T. Dibër, për periudhën 14.11.1992 - 07.09.2007.

- **D.R.T Dibër**, me shkresën nr. 35/54 prot., datë 01.06.2023, konfirmon se Majlinda Sulejman Hoxha nuk figuron e regjistruar si tatimpagues.

✚ **D.R.T Berat**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.05.2023, konfirmon se Majlinda Hoxha figuron si Person Fizik me NIPT *****, me aktivitet “tregti me pakicë”, regjistruar në datën 14.11.1992 dhe çregjistruar në datën 21.02.2007, për të cilin nuk ka të dhëna lidhur me fitimin e realizuar ndër vite, si dhe nuk ka detyrime tatimore të palikuiduara.

- **Në proces-verbalin e datës 19.06.2023**, lidhur me përgjigjet e DPT dhe DRT Berat, për subjektet tregtar me NIPT K3250**** dhe NIPT K363157****, subjekti ka sqaruar se nuk i përkasin bashkëshortes së tij.

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me sa më sipër.**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën *** prot., datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur.

❖ **Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe majaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;**

- ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale, deri në datë 08.03.2023, është deklaruar bruto/neto rreth **1.384.000 lekë.**

- Gjithashtu, subjekti ka deklaruar shpenzime të kryera si investime për banim dhe mobilim, për periudhën 1999 - 2023, në vlerën totale rreth **3.500.000 lekë**.
- ✓ Të ardhurat e subjektit, për periudhën Mars 1994 - Mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth **20.914.000 lekë**.
- ✓ Të ardhurat e bashkëshortes, për periudhën Shtator 2015 - Shkurt 2019, konfirmohen në vlerën totale rreth **1.492.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën Janar 2000 - Mars 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar (2 persona), rreth **7.831.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në total rreth **121.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022 janë deklaruar shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur, në total 600 euro e konvertuar rreth **70.000 lekë**.
- **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- **subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.**

V. KONTROLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:
 1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
 3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- ✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **z. Liman Imer Hoxha**, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka

kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Të dhënat e paraqitura në deklaratën për kontrollin e figurës janë të sakta dhe të vërteta.
- Është i vetëdijshëm se mosptësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të sjellë përjashtimin nga detyra, sipas ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, të ndryshuar.
- Firmosur më datë 08.03.2023

✚ Në përputhje me nenin 42 pika 1, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport për subjektin e vlerësimit, me nr. *** Prot, datë 20.07.2023, i përpiluar me përgjigjet e organeve ligjzbatuese dhe institucioneve shtetërore, në të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit Liman Hoxha.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

✚ Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet, agjencitë ligjzbatuese, nga ka rezultuar si vijon:

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, bën me dije se:

- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, ose lënie/marrje shtetësie.

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, bën me dije se:

- Në bazë të vendimit nr. ***, datë 30.10.1998, Gjykata e Tiranës (Ushtarake), e ka deklaruar fajtor për veprën penale të “*Plagosjes së rëndë nga pakujdesia*”, neni 80 K.P.U. dhe neni 406 K.PR.P. Dënohet me gjobë 5 000 lekë. Në bazë të nenit 69 të K.P është rehabilituar.
- Vetë subjekti i vlerësimit ka deklaruar në formular se, mbi bazën e vendimit nr.107, datë 30.10.1998 të gjykatës së Tiranës (Ushtarake) është deklaruar fajtor për veprën penale të “*Plagosjes së rëndë nga pakujdesia*”, neni 80 K.P.U. dhe neni 406 K.PR.P. Dënohet me 5 000 lekë gjobë dhe në bazë të nenit 69 të K.P është rehabilituar.
- **Institucion ligjzbatues**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije:
 - Nuk ka të dhëna/informacione të vërtetuara që janë të përfshirë ose të dyshuar për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar.
 - Nuk ka të dhëna/informacione për kontakte të papërshtatshme.
 - Nuk kanë të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare.
- **Institucion ligjzbatues**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, **nuk kanë**:
 - Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakt telefonik, etj;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit Nr.10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);
 - Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga nje autoritet Shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese Shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga nje shtet i huaj;
 - Të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
 - Të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
- **Institucion ligjzbatues**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, bën me dije se:

- Nuk disponon të dhëna.

✚ **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije;

- Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
- Nuk ka procedime penale të referuara;
- Për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që e lidhin me objektin e kërkesës.

✚ **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, bën me dije se **nuk**:

- Është nxjerr urdhër ndalimi;
- Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
- Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
- Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit;

✚ **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se;

- Rezultuan raportime financiare lidhur me personin e lidhur Majlinda Hoxha;
- Nuk rezultuan raportime lidhur me subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha.


✚ **Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, për subjektin e vlerësimit Z. Liman Imer Hoxha, bën me dije se:

- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret” lëshuar më datë 07.07.2022, e vlefshme deri më datë 06.07.2027.
- AKSIK, për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

✚ **Avokati i Popullit**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës;

- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

 **Institucion ligjzbatues**, për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, bën me dije se:

- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish- Sigurimi i Shtetit dri 02 Korrik 1991.

Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Liman Imer Hoxha, nuk është disponuar asnjë ankese nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e vlerësimit gjykojmë se:

Pavarësisht se, në vitin 1998 është dënuar me gjobë 5000 lekë për veprën penale “*Plagosje e rëndë nga pakujdesia*”, parashikuar nga neni 80 i Kodit Ushtarak Penal, subjekti i vlerësimit konsiderohet i Rehabilituar pasi, bazuar në nenin 69 të Kodit Penal, në germën “a” të tij citohet, “...quhen të padënuar ata persona që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit, nuk kanë kryer vepër tjetër penale..”.

Bazuar në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në Ministrinë e Brendshme”, neni 42, germa “a”, rezulton se subjekti i vlerësimit Z. Liman Imer Hoxha ka kryer deklarin të saktë, pasi faktin e mësipërm e ka pasqyruar në formular.

Bazuar sa më sipër, subjekti i vlerësimit Z. Liman Imer Hoxha, me detyrë Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e PLSH, Garda e Republikës së Shqipërisë, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

- **nuk u zbulua** prania e substancave të testuara. Subjekti nuk është përdorues.

VI . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse praë Gardës së Republikës, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar

Subjekti i vlerësimit **z. Liman Imer Hoxha** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin “Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore në Gardën e Republikës”

RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL GARDA E REPUBLIKËS.

Garda e Republikës është struktura përgjegjëse për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit **z. Liman Imer Hoxha**. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 46 pika 2, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport i hollësishëm për subjektin e vlerësimit, me nr. **** prot., datë 21.06.2023, i përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale.

HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT:

Struktura e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Gardës së Republikës si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr.**** prot., datë 21.06.2023, raportin e vlerësimit profesional.

Punonjësi i Gardës së Republikës, Liman Imer Hoxha është i emëruar me detyrë Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore, në Gardën e Republikës së Shqipërisë, me Urdhrin nr.****, datë 01.11.2021. Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Hoxha e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar.

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në.

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr.****.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar.

- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gardës së Republikës.

Të dhënat e siguruara nëpërmjet burimeve të mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit dhe nga vërtetimet e akte të tjera administrative të emërimeve në funksione, ecurinë disiplinore, eksperiencën e punës sipas vendit të punës, trajnimet, kualifikimet, medaljet si dhe vlerësimet e punës individuale

Nga shqyrtimi dhe analizimi i burimeve të mësipërme, mbi të cilat është mbështetur ky raport vlerësimi, konstatojmë dhe relatojmë si vijon:

❖ **VLËRËSIMI I NIVELIT TË ARSIMIT.**

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton së subjekti ka përfunduar arsimin e lartë.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
I mesëm	Shkolla e mesme ushtarake “Skënderbej”	1984	1988	Tiranë	Dëftesë pjekurie
I lartë	Akademia ushtarake “Skënderbej”	1988	1994	Tiranë	Diplomë

Në kuptim të ligjit Nr.33/2021, “Për Gardën e Republikës”, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacioni të administruar punonjësi **Liman Hoxha** subjekt vlerësimi:

Përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Gardës së Republikës, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

II.2. CERTIFIKATAT E TRAJNIMEVE, KUALIFIKIMEVE DHE MEDALJET:

Subjekti i vlerësimit në pjesën 3, pika 5 ka deklaruar pajisjen me certifikata për kryerje kursesh, trajnime brenda dhe jashtë vendit, si më poshtë:

- Kurs i forcave speciale - Regjimenti i zbulimit, Zall Herr, Tiranë, viti 1994.
- Kursi gjuhës turke - Shkolla e gjuhëve të huaja e Forcave Tokësore Turke, viti 1995.
- Kursi “Komando” - Qendra e stërvitjes alpine, viti 1995.
- Kurs për sigurinë e personaliteteve, me specialist turq - Garda e Republikës, viti 2000.
- Kursi kualifikimit për sigurinë e PLSH dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, Kajro, Egjipt, viti 2003.
- Kurs kualifikimi në fushën e rendit dhe sigurisë - Akademia e sigurisë, viti 2016.
- Kurs kualifikimi për gradën “Nënkolonel” - Akademia e sigurisë, viti 2018.

Për të vërtetuar saktësinë dhe vërtetësinë e deklaramit janë administruar të dhënat nga dosja e personelit, nr. *** që ndodhet në kartotekën e Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se deklarimi i punonjësit, subjekt vlerësimi është i saktë.

❖ **VLERËSIMET E PUNËS:**

Sipas vlerësimit të aftësive individuale të punës, të bërë nga eprori i drejtpërdrejtë, për periudhën 2018 - 2023, konstatohet:

- Për periudhën 2018 – 2019, nuk ka vlerësim.
- Për periudhën 2019 - 2020 është 29/45 "Kënaqshëm".
- Për periudhën 2020 – 2021, nuk ka vlerësim.
- Për periudhën 2021 – 2022, nuk ka vlerësim.
- Për periudhën 2022 - 2023 është 74/100 "Mirë".

Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr.*** Prot, datë 26.06.2023 i ka kërkuar Gardës së Republikës vlerësimet e punës për subjektin Liman Hoxha për vitet 2018 - 2020 dhe 2021, pasi mungonin.

Garda e Republikës, nëpërmjet shkresës nr. *** prot, datë 29.06.2023 konfirmon se në dosjen personale të subjektit Liman Hoxha, mungojnë formularët e vlerësimit të punës, për periudhat, vitet 2018 - 2019; 2020 - 2021, dhe 2021 - 2022.

Gjithashtu nga korrespondenca e mbajtur nëpërmjet postës elektronike të datës 09.09.2023, subjekti sqaroi se pas kontaktit me Sektorin e Burimeve Njerëzore të Gardës së Republikës, për shkak të ndryshimit të ligjit nuk ka patur vlerësim të rezultateve të punës.

Subjekti i vlerësimit ka paraqitur:

- Certifikatë “Për ngritjen në Gradën Nënkolonel për Oficerët e Gardës së Republikës” e vitit 2018.
- Raporte të vitit 2022 për kryerje shërbimesh.
- Analiza vjetore të vitit 2022, për të vërtetuar detyrat e tij funksionale.

Trupa e Vlerësimit, në këto kushte referuar nenit 45, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, mori në konsideratë kualifikimet e subjektit, vlerësimet e punës, certifikatat e trajnimeve, dokumentacionin provues të kryerjes së detyrave të tij funksionale, dhe arrin në konkluzionin se si objekt i vlerësimit të aftësive profesionale duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë nen. Por mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve nuk përben shkak për të qenë subjekt i nenit 47, pika 1, gërma “b”.

❖ MASAT DISIPLINORE

Punonjësi, subjekti i vlerësimit, **z. Liman Imer Hoxha**, në formularin e deklaramit ka deklaruar se nuk ka masë disiplinore.

Nga ana jonë janë administruar informacione nga dosja e personelit ku rezulton se:

Për subjektin e vlerësimit **z. Liman Imer Hoxha**, nuk ka masa disiplinore në fuqi dhe rezulton se deklarimi i subjektit është i saktë.

❖ ECURIA NË KARRIERË

Z. Liman Imer Hoxha ka plotësuar formularin e vlerësimit të aftësive profesionale duke listuar funksionet që ka mbajtur gjatë periudhës objekt vlerësimi;

- Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore 01.12.2021 - aktualisht
 - Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe familjeve të tyre 01.10.2020 - 01.12.2021
 - Shef i Qendrës së formimit dhe kualifikimit profesional 18.09.2020 - 01.10.2020
 - Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë Fizike të Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe familjeve të tyre 05.07.2018 - 18.09.2020
 - Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë Fizike të Personaliteteve të Larta Shtetërore 06.03.2017 – 05.07.2018
- Bazuar në rubrikën e punësimit, pjesë e dosjes personale e subjektit të vlerësimit, rezulton se subjekti i vlerësimit ka ushtruar funksionet, si më poshtë:

Periudha në Gardën e Republikës

- Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë Fizike të PLSH 05.07.2018-18.09.2020
- Shef i Qendrës së formimit dhe kualifikimit profesional 18.09.2020-01.10.2020
- Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e PLSH dhe familjeve të tyre 01.10.2020-01.12.2021
- Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të larta shtetërore 01.12.2021- aktualisht

Në lidhje me ecurinë në gradë punonjësi, subjekt vlerësimi, sipas dokumentacionit të administruar ka marrë:

- Nënkolonel 01.09.2017
- Drejtues 01.12.2021

Vërejmë se deklarimi i periudhave të punësimit dhe i ecurisë në gradë, nga subjekti Liman Hoxha, është i saktë dhe në përputhje me të dhënat e administruara në dosjen

personale të tij dhe me ecuri normale dhe të bazuar në arsimimin dhe aftësitë profesionale.

Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të **Z. Liman Imer Hoxha** arrijmë në konkluzionin se:

Pozicioni i mbajtur nga subjekti i vlerësimit Z. Liman Imer Hoxha si Drejtor i Drejtorisë për sigurinë e PLSH dhe si gradë, rezultojnë në përputhje me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

II.6. PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE, WORKSHOP-E, SEMINARE, BOTIME BRËNDA DHE JASHTË VENDIT

Z. Liman Imer Hoxha për periudhën objekt vlerësimi ka deklaruar se nuk është angazhuar në konferenca, Workshop-e dhe botime:

Nuk ka pjesëmarrje në veprimtaritë e sipër përmendura.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale Trupa e Vlerësimit konstatoi se subjekti është “I përshtatshëm” për ta ushtruar funksionin që mban.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit Liman Hoxha, në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **z. Liman Imer Hoxha** me funksion **Drejtor i Drejtorisë për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore, në Gardën e Republikës së Shqipërisë.**
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gardës së Republikës, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, (të ndryshuar).
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot më datë 28.02.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Ersa Karaj

Kryesues

Klevis Dhigoi

Relator

Erjana Pjetri

Anëtar